

D E K R E T
Nr.7464, datë 31.1.1991

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 4171, DATË 13.9.1966 "PËR SIGURIMET
SHOQËRORE SHTETËRORE TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË
SHQIPËRISË" DHE NË LIGJIN NR. 4976, DATË 29.6.1972 "PËR PENSIONET E
ANËTARËVE TË KOOPERATIVAVE BUJQËSORE"**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës;
Me propozimin e Këshillit të Ministrave;

**PRESIDIUMI I KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.4171, datë 13.9.1966 "Për Sigurimet Shoqërore të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" bëhen këto ndryshime:

Pas nenit 17/a shtohet neni 17/b me këtë përmbajtje:

"Punëtori ose nëpunësi që sipas nenit 17 të këtij ligji ka 5 vjet për të mbushur moshën për pension pleqërie të plotë, me kërkesën e tij dhe me pëlqimin e qendrës së punës, merr pension të parakohshëm në masën 60 për qind të pagës mesatare mujore, që nxirret nga shuma e përgjithshme e pagave të marra gjatë 3 vjetëve me rradhë brenda 10 vjetëve të fundit të punës.

Pensioni i parakohshëm nuk mund të jetë më i lartë se 700 lekë në muaj".

- Pas nenit 19 shtohet neni 19/a me këtë përmbajtje:

"Personat e lindur të sëmurë ose që janë sëmurur a aksidentuar para moshës 18 vjeç ose gjer në moshën 25 vjeç kur vazhdojnë shkollën dhe për nga sëmundja barazohen me invalidët e grupit I ose II marrin ndihmë në masën 200 lekë në muaj, kur nuk përfitojnë pensione.

Koha e fillimit të sëmundjes dhe paaftësia për punë caktohen nga Komisioni i ekspertimit mjeko-punëtor".

- Paragrafi i katërt i nenit 26 ndryshohet si më poshtë:

"Invalidit të grupit IV i paguhet pensioni edhe në rastet kur nuk sistemohet në punë".

- Shtohet neni 69 me këtë përmbajtje:

"Personat që largohen nga Shqipëria me lejen e shtetit shqiptar kanë të drejtë të përfitojnë pensione në lekë që u takojnë sipas dispozitave të këtij ligji.

Rregullat për pagimin e pensioneve caktohen nga Ministria e Financave".

Neni 2

Në ligjin nr. 4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore", bëhen këto shtesa:

Pas nenit 9/a shtohet neni 9/b me këtë përmbajtje:

"Personat e lindur të sëmurë ose që janë sëmurur a aksidentuar para moshës 18 vjeç ose gjer në moshën 25 vjeç kur vazhdojnë shkollën, dhe për nga sëmundja barazohen me invalidët e grupit I ose II marrin ndihmë në masën 150 lekë në muaj, kur nuk përfitojnë pensione.

Kjo ndihmë jepet nga kooperativa bujqësore me fondet e saj.

Koha e fillimit të sëmundjes dhe paaftësia për punë caktohen nga Komisioni i ekspertimit mjeko-punëtor"

Pas nenit 31 shtohet neni 32 me këtë pëmbajtje:
"Personat që largohen nga Shqipëria me lejen e shtetit shqiptar kanë të drejtë të përfitojnë pensione në lekë që u takojnë sipas dispozitave të këtij ligji.
Rregullat për pagimin e pensioneve caktohen nga Ministria e Financave".

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI
SIHAT TOZAJ

KRYETARI
RAMIZ ALIA